



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

**Rasti:** Përftimi i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Stellantis N.V dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 627 prot. i AK, datë 21.10.2022 “Përqendrimi ndërmjet Stellantis N.V dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd./ JV”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me themelimin e një joint – venture me funksione të plota, të kontrolluar në mënyrë të përbashkët nga shoqëritë Stellantis N.V, dhe Hon Hai Precision Industry Co., Ltd.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët”, palët janë:

**Pala 1: Stellantis N.V.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt aktiviteti: Aktivitetet financiar, etj.

Stellantis N.V. nuk ka filiale, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Xhiroja e realizuar në tregun shqiptar është gjeneruar nëpërmjet një distributori të pavarur, palë e tretë.

**Pala 2: Hon Hai Precision Industry Co. Ltd.** është një shoqëri aksionare, listuar në Bursën e Korporatave në Taivan, si një prodhues shumëkombësh tajvanez i kontratave elektronike.

Foxconn është shoqëria mëmë e Foxconn Group, një prodhues ndërkombëtar i pajisjeve elektronike dhe ofrues i zgjidhjeve teknologjike.

Foxconn Group nuk ka degë/filiale të regjistruara në Shqipëri. Xhiroja e gjeneruar në tregun shqiptar, gjenerohet nëpërmjet filialit indirekt të Hon Hai, Belkin International, Inc, për shitjen e aksesoreve të celularëve dhe pajisjeve kompjuterike.

**Shoqëria e përbashkët (JV)** do të jetë me seli ligjore Holandë, e cila do të vendoset në mirëkuptim nga Stellantis dhe Foxconn, dhe do të kryejë veprimtari të pavarur si një entitet ekonomik autonom. Stellantis dhe Foxconn synojnë të themelojnë një Joint Venture me funksione të plota, e cila do të jetë kryesisht aktive në projektimin dhe furnizimin e gjysmëpërçuesve për industrinë e automjeteve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**